Aneksi A

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Komandant skuadre/ shofer /shef VKT	5001 AFA	Tiranë	Për një kohëzgjatje të përcaktuar	po	jo	10.11.2026	20.11.2026

SHPALLJE VENDI I LIRË PUNE

1.Pozicioni i punës: Komandant skuadre/ shofer /shef VKT
2. Kodi i pozicionit: LF 2300
3. Reparti/Institucioni: RU.5001 AFA
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: Sipas VKM-së, nr.326, datë 31.05.2023, e ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Për një kohëzgjatje të përcaktuar
7. Data e fillimit të aplikimit: 10.11.2026
8. Data e mbylljes së aplikimit: 20.11.2026
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Njësisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën (adresa postare e repartit/strukturës përkatëse): *Sektori i Burimeve Njerëzore* *Rektorati dhe Drejtoritë* *Akademia e Forcave të Armatosura* *Tiranë*
10. Dokumentet e aplikimit: Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme: ▪ kërkesën; ▪ formularin e aplikimit; ▪ fotokopje të kartës së identitetit; ▪ diplomën e shkollës ciklit te mesëm ▪ raport mjekësor; ▪ fotografi me përmasa 4x6, 2 copë; ▪ dëshmi penaliteti;

- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (*linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit)*

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

a) të ketë shtetësinë shqiptare;
b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
d) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

a. Grada/Titulli: Civil II
b. Arsimi : i mesëm
c. Eksperiencë në Punë

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve,
- Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kerkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve;

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
b. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:
jetëshkrimi, 5 pikë;
eksperienca/përvoja në punë, 15 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.